

Pyetje: Cilat janë paketat shëndetësore nga të cilat qytetarët përfitojnë mbulim falas, si në sistemin shëndetësor publik ashtu edhe në atë jopublik?

Përgjigje: Vendimi i KM Nr. 308, datë 21.05.2014 “Për miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga Fondi i Sigurimit të detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në shërbimin spitalor”, i ndryshuar, vendosi për paketat shëndetësore që do të financohen dhe çmimet përkatëse. Implementimi i ofrimit dhe financimit të paketave shëndetësore, u realizua nga FSDKSH me spitalet publike dhe jopublike, sipas kontratave të lidhura ndërmjet tyre gjatë vitit 2014.

Fondi autorizon pacientët për të marrë shërbimin e nevojshëm të paketave shëndetësore, në institucionet shëndetësore jopublike vetëm për rastet përtej kapaciteteve mjekësore të institucioneve shëndetësore publike, në përputhje me kapacitetet e lira të raportuara nga spitalet publike.

Paketat shëndetësore që financohen nga Fondi janë:

Paketa e Dializës

Shërbimi i paketës së dializës ofrohet nga 1 spital publik, 8 institucione shëndetësore jopublike.

Paketa e Kardiologjisë

Në paketën e kardiologjisë përfshihen këto procedura mjekësore:

- Pacemaker definitiv
- Angiografi koronare
- Angioplastikë koronare (PCA)
- Angiografi + Angioplastikë

Shërbimi për paketën shëndetësore të Kardiologjisë aktualisht mbulohet nga:

Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë, e cila kryen numrin më të madh të procedurave mjekësore, Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi” Tiranë, spitali rajonal “Memorial” Fier dhe spitali rajonal Shkodër.

Paketat shëndetësore në shërbimin e Kardiokirurgjisë

Në paketën e kardiokirurgjisë përfshihen këto procedura mjekësore:

1. By pass aorto koronar
 - 1.1. By Pass + Plastike e Valvulës
 - 1.2. By Pass + Zëvendësim me Valvul Mekanike
 - 1.3. By Pass + Zëvendësim me Valvul Biologjike
2. Valvular
 - 2.1. Mono Valvular me Protezë Mekanike
 - 2.2. Mono Valvular me Protezë Biologjike
 - 2.3. BI Valvular me Protezë Mekanike

2.4. BI Valvular me Protezë Biologjike

3. Interventi Kongenital

Shërbimi për paketën shëndetësore të Kardiokirurgjisë, mbulohet aktualisht nga Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë.

Paketa e Implantit Koklear e cila mbulohet nga QSUT.

Paketa e vendosjes së Fistulës dhe Graftit

Paketat ofrohen nga QSUT dhe nga spitali jopublik “Amerikan”¹ dhe spitali jopublik “Hygeia”.

Paketa e Kataraktës

Ofrohet nga spitalet publike QSUT dhe spitalet rajonale, Fier e Vlorë, Durrës, Spitali Universitar i Traumës.

Paketa e radioterapise (trajtimi me akselerator linear) ofrohet aktualisht nga QSUT.

Pyetje: Sa është numri i personave që kanë përfituar secilën prej këtyre paketave? Po fondi i nevojshëm për të mbuluar shpenzimet për këto pacientë? Sa prej tyre i kanë përfituar në sistemin privat dhe sa në sistemin publik? Ju lutem edhe fondi të jetë i ndarë vec në spitale publike dhe vec për spitale private...

Përgjigje: Per vitin 2021 paketat shendetesore jane ofruar kryesisht nga spitalet publike. Jashte kapaciteteve mjekesore publike disa paketa jane ofruar ne spitale private.

dialize	2021		
	persona perfitues	seanca dialize	vlere
Spitale Jopublike	812	119,187	1,442,877,822
Spitale Publike (QSUT)	112	10,860	131,471,160

Nr	paketat shendetesore	Spitale Publike		Spitale jopublike	
		Perfitues	Vlere	Perfitues	Vlere
1	pacemaker	412	44,596,116	-	-
2	angiografi	3,531	161,437,320	-	-
3	angioplastike	202	28,284,848	-	-
4	angiografi + angioplastike	2,958	441,333,600	-	-
5	By pass aorto koronar	343	153,208,839	-	-
6	By Pass + Plastike e Valvules	40	19,995,640	-	-
7	By Pass + Zevendesim me Valvul Mekanike	32	16,743,456	-	-
8	By Pass + Zevendesim me Valvul Biologjike	30	16,264,440	-	-
	By Pass + Zevendesim me Valvul Mekanike: (1)				
9	Valvul Aortale + (1) Valvul Mitrale	-	-	-	-
10	mono valvular me proteze mekanike	80	42,096,640	-	-
11	mono Valvular me Proteze Biologjike	49	27,030,948	-	-
12	BI Valvular me Proteze Mekanike	7	4,585,924	-	-
13	BI Valvular me Proteze Biologjike	10	6,731,330	-	-
14	Intervetet kongenitale	63	22,019,949	-	-
15	implant koklear interventi	15	2,735,355	-	-
16	implant koklear aparati	-	-	-	-
17	transplant veshke	-	-	23	26,494,666
18	terapia e flakjes akute	-	-	-	-
19	vendosja e fistules	112	1,294,832	80	924,880
20	vendosja e grafitit	9	488,799	26	1,412,086
21	katarakta	3,018	65,701,860		
	TOTALI	10,911	1,054,549,896	129	28,831,632

Pyetje: Si ka ndryshuar përgjatë këtyre 5 viteve Buxheti i Fondit të Sigurimeve Shëndësore lidhur me paketat?

Përgjigje:

	000,000 leke
Viti	Plani i buxhetit
2017	39,405
2018	40,400
2019	42,487
2020	43,704
2021	50,226
2022	52,836